



## SYLLABUS I LËNDËS “ENTOMOLOGJIA E PYJEVE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
Titulli i lëndës:	Entomologjia e Pyjeve
Programi:	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (SHPM)
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Detyruese (Obligative)
Viti i studimeve:	II (i dytë)
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Do të përcaktohet
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Albana Plakiqi Milaimi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: +383 44 187 368 E-mail: albana.milaimi@uni-prizren.com
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Në këtë lëndë fillimisht përshkruhet nocioni, rëndësia, qëllimi, historiku, zhvillimi dhe lidhshmëria e Entomologjisë me shkencat tjera. Pastaj, analizohet roli i insekteve në natyrë; Morfologjia dhe anatomia e insekteve (sistemet e organeve); shumimi dhe mënyrat e shumimit; Zhvillimi para dhe pasembrional i tyre, depozitimi i vezëve, kujdesi për brezni. Do të diskutohet për Insektet me zhvillim jo të plotë (Hemimetabola) dhe ato me zhvillim të plotë (Holometabola), për larvat, nimfat dhe imago. Në kurs janë të përfshira edhe dimorfizmi, polimorfizmi dhe diapauza. Rëndësi e veçantë u kushtohet klasifikimit të insekteve, ku me këtë rast bëhet njohja me përfaqësuesit e grupeve (gjinive, familjeve, rendeve) të insekteve, përfshirë insektet pa krahë- <i>Apterygota</i> (Protura, Diplura, Collembola, Thysanura) dhe insektet me krahë - <i>Pterygota</i> (Orthoptera, Blattodea, Mantodea, Isoptera, Dermaptera, Thysanoptera, Heteroptera, Homoptera, Coleoptera, Lepidoptera, Diptera, dhe Hymenoptera). Më pas diskutohet për nocionin e ekologjisë; për faktorët ekologjikë, rëndësinë dhe klasifikimin e tyre. Poashtu, theks i veçantë do t'i kushtohet edhe faktorëve abiotikë dhe biotikë që ndikojnë në insektet fitofage, si dhe masat për menaxhimin e pyjeve nga dëmtuesit. Pjesa e fundit e kursit përfshinë format e prodhimit dhe mënyra e përdorimit të preparateve kimike; Toksikologjinë - masat dhe mjetet mbrojtëse që duhet marrë gjatë punës, si dhe klasifikimin e mjeteve kimike për mbrojtjen e bimëve (Insekticidet, Akaricidet, Nematocidet, Rodenticidet, etj).
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	Objektiv i këtij kursi është që studentëve t'u ofrohen njohuritë themelore mbi anatominë, morfologjinë, mënyrën e shumimit dhe llojet e dëmtuesve pyjorë, si dhe efektet që ato shkaktojnë në pyje.
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Të njohin karakteristikat morfologjike, anatomike, fiziologjike dhe taksonominë e insekteve dëmtues të bimëve si dhe biologjinë e ekologjinë e tyre.</li><li>2. Të njohin insektet kryesorë dëmtues të bimëve pyjore dhe dinamikën e popullatave të tyre.</li><li>3. Të njohin karakterin e dëmit të shkaktuar nga insektet në bimë.</li></ol>



	<p>4. Të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për metodat e monitorimit dhe të kontrollit të insekteve fitofagë.</p> <p>5. Njohurit e fituara ti aplikojnë në praktikë</p>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	5	1 javë	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 javë	5
Ushtrime në terren	/	/	/
Kollokfiume, seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10 javë	10
Përgatitja përfundimtare për provim	3	10 javë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	6	1 javë	6
Projektet, prezantimet ,etj	/	/	/
<b>Totali</b>			<b>120</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator dhe pyje, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokuiume, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Mundësia e vlerësimit gjatë leksioneve: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, vlerësimi i dytë : 15 %, provimi praktik: 10%, Provimi final: 50%, Total: 100%.		
<b>Mjetet e konkretizimit</b>	Kompjuterë, projektori, insectraiumet, etj.		
<b>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:</b>	1:1 (2+2 orë).		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jaço N. 2008: Mbrojtja e Pyjeve – Entomologjia.</li> <li>2. Ciesla W. 2011: Forest Entomology. Wiley- Blackwell, A Jon Wiley &amp; Sons, Ltd., Publication.</li> <li>3. Schowalter, T. (2006): Insect Ecology.Academis pres publication. United States of America.</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Berkeley BioKeys: Insecta. 2007. Berkeley Natural History Museums. University of California.<a href="http://biokeys.Berkeley.edu/inverts/insecta_orders.html">http://biokeys.Berkeley.edu/inverts/insecta_orders.html</a></li> </ol>		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>



<i>Java e parë:</i>	Shkenca e Entomologjisë; Historiku dhe rëndësia e saj.	Mbledhja dhe konzervimi i insekteve
<i>Java e dytë:</i>	Morfologjia e Insekteve.	Përcaktimi i grupeve të insekteve në bazë të morfologjisë së tyre
<i>Java e tretë:</i>	Anatomia e insekteve; Zgavra trupore dhe sistemet e organeve të brendshme.	Njohja e anatomisë së insekteve; forma dhe funksioni i organeve
<i>Java e katërt:</i>	Sistemi i shumimit të insektet; Gametogjeneza	Puna në mbledhjen e insekteve
<i>Java e pestë:</i>	Zhvillimi embrional dhe pasembrional i insekteve.	Identifikimi i formave imature të insekteve
<i>Java e gjashtë:</i>	Insektet Hemimetabola dhe Holometabola	Mbledhja dhe ruajtja e specieve tokësore të insekteve
<i>Java e shtatë:</i>	Stadet e zhvillimit të insekteve; Dimorfizmi dhe polimorfizmi. Diapauza; Cikli biologjik i insekteve <b>Vlerësimi i parë intermerdier</b>	Mbledhja dhe ruajtja e specieve ujore të insekteve
<i>Java e tetë:</i>	Kriteret e klasifikimit të insekteve. Njohja me përfaqësuesit e grupeve (gjinive, familjeve, rendeve).	Përdorimi i çelësit për identifikimin e familjeve të insekteve hemimetabolike
<i>Java e nëntë:</i>	Insektet Apterygota dhe Pterygota	Përdorimi i çelësit për identifikimin e insekteve holometabolike (Coleoptera dhe Lepidoptera)
<i>Java e dhjetë:</i>	Ekologjia e insekteve	Përdorimi i çelësit për identifikimin e insekteve holometabolike (Diptera, Hymenoptera)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Klasifikimi i mjeteve kimike për mbrojtjen e bimëve	Shembuj të ndikimit të faktorëve abiotik në shumimin e insekteve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Dëmtuesit e pyjeve halore	Ndikimi i temperaturës dhe zhvillimi i insekteve të dëmshme të pyjeve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Dëmtuesit e pyjeve gjethrënës	Ndikimi i insekticideve të ndryshme në zhvillimin e insekteve
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Masat për menaxhimin e pyjeve nga dëmtuesit	Përdorimi i halave të pishës si insekticide natyrore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Forma e prodhimit dhe mënyra e përdorimit të preparateve kimike; Toksikologji dhe masat mbrojtëse gjatë punës. <b>Vlerësimi i dytë intermerdier</b>	Përdorimi i specit dhe hudhrës si insekticide natyrore
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe në punë seminarike; Mbajtja e qetësisë në mësim, ç'kryerja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj.		